

Nr. 19/29 Prot.

DA. 16. 11. 2012



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

6058/
Nr. ... Prot.

2

Tiranë, më 16.11.2012

URDHËR

Nr. 557, datë 16.11.2012

PËR

AKREDITIMIN INSTITUCIONAL TË AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 14.09.2011 "Për licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit":

URDHËROJ:

1. Akreditimin institucional, në përputhje me vendimin nr. 394, datë 26.10.2012 të Këshillit të Akreditimit, të Akademisë Profesionale të Biznesit.
2. Akademia Profesionale e Biznesit të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, një raport për plotësimin e rekomandimeve të vëna nga Këshilli i Akreditimit në vendimin nr. 394, datë 26.10.2012 të tij, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Akademia Profesionale e Biznesit i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik. Bazuar në pikën 4, të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, vlerësimi dhe akreditimi periodik kryhet çdo 6 vjet.
4. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Akademia Profesionale e Biznesit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ

MINISTËR

